

# Pse duhet të përdor shërbimet e përkthyesve?

Departamenti i Shërbimeve të Përkthyesve i "Michigan Medicine" ka garantuar akses të plotë në kujdes shëndetësor cilësor për mbi 20 vjet. Ekipi ynë i përkthyesve është i certifikuar, i trajnuar nga ana mjekësore dhe tejet i kualifikuar. Ky shërbim është:

- Pa pagesë
- Konfidencial
- I disponueshëm 24 orë në 7 ditë të javës



# Ka mjekë që vijnë pa një përkthyes?

E dimë që mjekët kanë agjenda të ngjeshura, por është e rëndësishme që ata të dëgjojnë çdo gjë që duhet të thoni për sa i përket kujdesit tuaj shëndetësor. Përkthyesit nëpërmjet telefonit mund të përdoren si alternativë në minutë të fundit. Duhet të prisni vetëm pak minuta për t'u lidhur me një përkthyes. Mund t'i kërkonit infermieres një telefon me dy receptorë për të zëvendësuar telefonin pranë shtratit tuaj.

Gjithashtu, gëzoni të drejtën që t'i kërkonit çdo ofruesi kujdesi shëndetësor që të rikthehet më vonë bashkë me një përkthyes. Nuk duhet të ndiheni i detyruar të përdorni miqtë ose familjarët si përkthyes vetëm sepse mjekët kanë ardhur tashmë. Në fakt, Komisioni i Përbashkët rekomandon të kundërtën.

## Shërbimet e përkthyesve



734-936-7021



[interpreterservices@med.umich.edu](mailto:interpreterservices@med.umich.edu)



<https://www.uofmhealth.org/support-services/interpreter-services>



## Shërbimet e përkthyesve

# Pas daljes nga spitali

Nëse keni nevojë të telefononi spitalin për informacione të mëtejshme për kujdesin tuaj shëndetësor, mund të telefononi në:

844-562-3982

Kjo do t'ju lidhë automatikisht me shërbimet e përkthimit, të cilat më vonë do të telefonojnë mjekun ose klinikën.



## Fraza të dobishme

Gjatë qëndrimit në spital, mund të ketë ndërveprime të shkurtra me infermieren ose me ofrues të tjerë të kujdesit shëndetësor gjatë të cilave nuk do të donit të prisnit për një përkthyes. Këtu jepen disa fraza të zakonshme që mund të përdorni për t'ju ndihmuar të komunikoni me ekipin tuaj të kujdesit shëndetësor, që ata të kuptojnë nevojat tuaja.

Dua të porosis për të ngrënë.  
(I want to order a meal.)

Ku është ushqimi që porosita?  
(Where is the food I ordered?)

Dua të lëviz për te karrigia.  
(I want to move to the chair)

Dua të lëviz për te shtrati.  
(I want to move to the bed)

Dua të ndryshoj pozicionin në shtrat.  
(I want to be repositioned in bed.)

Ju lutem, thuajini mjekut që kam disa pyetje.  
(Please inform the doctor that I have some questions.)

Kur mund të shkoj në shtëpi?  
(When will I go home?)

Dua një bar për të kontrolluar dhimbjen.  
(I would like some medication to control my pain.)

Niveli im i dhimbjes është:  
(My pain level is:)

1	2	3	4	5
6	7	8	9	10

Nuk e kuptoj se çfarë po thoni.  
Ju lutem, thërrisni një interpret.  
(I don't understand what you are saying. Please call an interpreter.)

Ju lutem, kthehuni përsëri më vonë.  
Nuk dëshiroj të flas me askënd/të diskutoj për asgjë në këtë moment.  
(Please come back later. I don't want to talk to anyone/discuss anything right now.)

Kam nevojë të përdor tualetin.  
(I need to use the bathroom.)

Dua të bëj dush/banjë.  
(I want to shower/bathe.)

Më duhet aparati i dëgjimit.  
(I need my hearing aids.)

Më duhen protezat e dhëmbëve.  
(I need my dentures.)

Më duhen syzet e leximit.  
(I need my reading glasses.)